



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/L - 40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 08.01.2021, merr këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**

**FORMIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËS**  
**SË KUVENDIT PËR VITIN 2021**

I. Miratohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.

II. Grupi punues nga pika I e këtij vendimi, është në këtë përbërje:

1. **Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit,**
2. **Sami Salihu, LDK, anëtar,**
3. **Bashkim Beha, PSD, anëtar,**
4. **Mirsad Vitia, LVV, anëtar,**
5. **Leutrim Retkoceri, PDK, anëtar,**
6. **Valbona Ajeti, AAK, anëtare,**
7. **Rifat Deri, AKR, anëtar,**
8. **Fiknete Bejta, Grupi i pavarur, anëtare,**
9. **Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, anëtar,**
10. **Luljeta Selimi, përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit, anëtare,**
11. **Diellon Gjonbalaj, përfaqësues i Zyrës ligjore, anëtar.**

III. Detyrë e grupit punues të cekur në pikën II të këtij vendimi, është që në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë që ka Kuvendi i Komunës me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisje lokale, dispozitat e ligjeve të tjera - pjesën me kompetencë të komunës, aktet nënligjore dhe Statutin e Komunës, të hartojë planin vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021. Pas hartimit të planit final, grupi punues do ta prezantojë para Kuvendit të Komunës për miratim.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**01-020/04-4412/21, më 11.01.2021**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Agim Kuleta**

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 381(0)38/230-900  
<http://eëë.prishtina-komuna.org>

